



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Data: 6 Gusht 2019

Njoftim publik

Me qëllim të sigurimit të plotë të barnave që jepen me recetë në kuadër të Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që njëherit është edhe një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së RMV-së, dhe duke patur parasysh se viteve të fundit kjo ka reflektuar problem tek të siguarit për shkak të egzistimit të kuotave të barnatoreve respektivisht kufizimit financiar për barnatoret për të dhënë barna me recetë nga lista pozitive parësore, Ju njoftojmë:

- ❖ Fondi në mënyrë intensive ka ndërmarrë aktivitete dhe masa përkatëse për heqjen e kuotave tek të gjitha barnatoret dhe për të zbatuar mehanizëm të rij për kontroll të ordinancave gjatë përshkrimit të barnave me recetë që jepen në kuadër të Fondit, si dhe për marrjen e barnave nga barnatoret duke paraqitur dokumentin personal për identifikim (letrën e njoftimit ose pasaportën) nga personi i cili e merr barin.
- ❖ Barin me recetë nga barnatorja i siguruari mund t'a marrë vetëm nëse identifikohet me letër njoftimi ose pasaportë. Në rastet kur personi i siguar, për shkaqe shëndetësore ose shkaqe tjera nuk mund të jetë personalisht prezent për t'a marrë barin nga barnatorja, në emër të tij do mund të kryejë shërbim person tjetër respektivisht të marrë barnat e nevojshme duke u identifikuar personalisht me letrën e njoftimit ose pasaportën.
- ❖ Fondi për sigurim shëndetësor angazhohet për të ulur rezikun nga keqpërdorimet e mundshme sa i përket përshkrimit jo-racional dhe përdorimin e barnave duke zbatuar procedura shtesë dhe mehanizma kontroli.
- ❖ Të gjitha këto përpjekje duhet të mundësojnë qasje të barnave me recetë përgjatë gjithë muajit, e jo si deri tani kur për shkaqe të kuotave të realizuara plotësisht deri në një ditë brenda muajit, barnatoret mbeteshin pa barna me recetë për të siguarit.
- ❖ Modeli i barnatoreve pa kuota ka filluar të aplikohet si pilot projekt në muajin Gusht të vitit 2019 nëpër 43 barnatore, që janë të pozicionuara në qendrat turistike të territorit nëpër njësitë rajonale të Fondit edhe atë në Strugë, Ohër, Prespë dhe Gjevgjeli të paraqitura si në tabelën më poshtë:

FSSHRMV – Njësia rajonale	Vendbanimi – qendra turistike
STRUGË	Strugë
OHËR	Ohër
OHËR	Peshtani
PRESPË	Krani
PRESPË	Carev Dvor
GJEVGJELI	Nov Dojran

Njëkohësisht Ju kumtojmë se deri në momentin e heqjes së kuotave tek të gjitha barnatoret, në muajin Gusht tek barnatoret ku aplikohet pilot projekti, dhënia e barnave me recetë do të kryhet si më parë.

Me respekt,
FSSHRMV